

VENDIM
Nr.1114, datë 13.11.2009

**PËR DHËNIEN E BURSIVE NXËNËSVE TË SHKOLLËS SË MESME
PROFESIONALE “PETER MAHRINGER”, SHKODËR, PËR VITIN SHKOLLOR 2009-
2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të ligjit nr.9522, datë 25.4.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunimin në fushat e kulturës, të arsimit dhe shkencës”, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës të 42 (dyzet e dy) bursave të studimit, nga të cilat 16 (gjashtëmbëdhjetë) bursa studimi për nxënësit e viteve të para, 12 (dymbëdhjetë) bursa studimi për nxënësit e viteve të dyta dhe 14 (katërmëdhjetë) bursa studimi për nxënësit e viteve të treta të shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, Shkodër, për vitin shkollor 2009-2010.

2. Vlera e bursës të jetë 680 (gjashtëqind e tetëdhjetë) euro për nxënës, në vit, për shlyerjen e tarifës mujore të shkollimit dhe për mbulimin e kostos së teksteve mësimore.

3. Fondi për mbulimin e këtyre bursave kalon nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në drejtorinë arsimore rajonale, Shkodër.

4. Miratimi i këtyre bursave bëhet nga bordi i “Fondacionit Shkollor Austriak”, në mbështetje të kriterëve ekonomike dhe të rezultateve të arritura nga secili nxënës/aplikant.

5. Bordi i “Fondacionit Shkollor Austriak”, pas miratimit të bursave, dërgon dokumentacionin përkatës në drejtorinë arsimore rajonale, Shkodër, e cila pas konfirmimit të nxënësve, që përfitojnë bursë, e derdh vlerën e bursës në llogarinë personale të secilit nxënës.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyj në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha